Project: Date ...... /...... / ...........

Protokoll Nr 6

Ky protokoll mbahet sot më datë 26.6.2026, ora 10[00] në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Divjakë kati i dytë, në godinën e Bashkisë, për zhvillimin e mbledhjes së radhës, për muajin Qershor 2026

Në mbledhje morën pjesë Këshilltorët:

Lin Biti, Fotjona Budani, Kjori Balla,
Donika Stasa, Blerim Dovidhi, Alketa Canaku
Elmerina Sina, Xhorxhi Krali, Indrit Zejana
Ajete Mebelli, Gojart Agolli,
Elda Sinani, Roza Broshku, Majlinda Xhoro
Drita Metani Mishel Verdha,
Sahit Ibrahimaj, Antuela Gjini,
Adelajda Culi

Meqënëse u plotësua kuorumi i numrit të këshilltorëve për zhvillimin e mbledhjes së radhës, Sekretarja e Këshillit znj. Lin Biti, e deklaron mbledhjen e muajit Qershor të hapur dhe kalon në rendin e ditës:

Rendi i ditës.

1. Miratim i rendit të ditës.
2. Miratim i Procesverbalit të mbledhjes së dt. 25.5.2026.
3. Informacion mbi zbatimin e VKB për muajin Maj 2026.
4. Projekt vendim Nr. 50, datë 08.06.2026 "Për shuarje mandati këshilltores "Zj. Drita Miti Metani".
5. Projekt vendim Nr. 51, datë 10.06.2026 "Për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Maj 2026
6. Projekt vendim Nr. 52 datë 12.06.2026 "Për miratimin e PBA, të Bashkisë Divjakë për vitet 2027-2029 faza e parë
7. Projekt vendim Nr 53 dt. 12.06.2026 "Për një ndryshim në VKB nr 19 dt. 27.02.2026 "Për transferimin e fondeve nga Buxheti i Bashkisë Divjakë në shoqërinë "Kryelis sh.p.k"
8. Projekt vendim Nr 54 dt. 12.06.2026 Për një ndryshim në VKB nr 90 dt. 29.12.2025 "Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve në varësi dhe të Njësive Administrative, për vitin 2026
9. Projekt vendim Nr. 55 dt. 16.06.2026 Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare për shtetasin Renato Arizhiu për banesën e dëmtuar nga zjarri.

10. Projektvendim Nr 56 dt. 16.06.2026: Mbi akordimin e ndihmës financiore për subjektin "Agrigore".
11. Projektvendim Nr 57 dt. 16.06.2026: Mbi akordimin e ndihmës financiore për familjet e dëmtuara nga zjarri.
12. Relacion: Mbi monitorimin e zbatimit të Buxhetit për periudhën Janar- Prill 2026.

1. Pika e parë e rendit të ditës.
- Miratimi i rendit të ditës.

Kryetarja zj. Lin Biti i drejtohet këshilltarëve të pranishëm. A kemi pyetje, diskutime, shtesa dhe pakësime për rendin e ditës?

Fjalën e merr Kryetarja e Komisionit të Ekonomisë dhe financave zj. Fotjola Budani, ku propozon shtesë në Rendin e ditës Projektvendimet e paraqitura nga Bashkia:

1- Projekt-vendimin Nr. 58 dt. 22.6.2026 Mbi miratimin për familjet në nevojë për dhënien e ndihmës financiore të menjëhershme.

2- Projektvendimin Nr 59 datë 24.06.2026 "Për anullimin e Vendimit të KB Nr. 45 dt. 25.5.2026 "Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare nga fondi i kushtëzuar, Shtetasve të cilëve u janë dëmtuar banesat nga fatkeqësi të ndryshme.

3- Projektvendimin nr 60 dt. 24.06.2026 "Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare nga fondi i kushtëzuar, shtetasve të cilëve u janë dëmtuar banesat nga fatkeqësi të ndryshme"

4- Informacion mbi kërkesën e këshilltarit z. S. Ibrahimaj.

Propozoj gjithashtu që këto Projektvendime të renditen pas pikës 11 në Rendin e ditës, dhe Informacioni pas Relacionit.

Pyetje dhe diskutime të tjera s'ka.

Hidhet në votim pika e parë e rendit të ditës, si Bashkim me shtesat e propozuara, dhe votohet me 18 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

2. Pika e dytë e rendit të ditës.
- Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së dt. 25.05.2026.

Kryetarja zj. Lin Biti: A kemi pyetje apo diskutime rreth procesverbalit të mbledhjes së dt. 25.5.2026?

Pyetje s'ka, diskutime s'ka.

Hidhet në votim pika e dytë e rendit të ditës dhe votohet me 18 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

Project: Date ...... /...... / ...........

3. Pika e tretë e rendit të ditës.
- Informacion mbi zbatimin e VKB për muajin Maj 2026.
Sekretarja zj. Lin Biti i drejtohet Këshilltarëve duke u shprehur se këtë informacion e keni në materialet tuaja nëse keni ndonjë pyetje apo diskutim? Pyetje dhe diskutim për pikën e tretë të rendit të ditës nuk ka.

4- Pika e katërt e rendit të ditës
- Për dhënie mandati këshilltares Zj. Drita Miti Metani.
Raportin e Komisionit të verifikimit të mandateve e lexon Zv. Sekretarja e komisionit zj. Fotjona Budani, ku i propozon Këshilltarëve të miratojnë dhënien e mandatit këshilltares Zj. Drita Miti Metani, përfaqësuese i subjektit Politik "Partia Agrare Ambjentaliste" (PAA). Pyetje dhe diskutime s'ka. Hidhet në votim pika e katërt e rendit të ditës dhe votohet me 18 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim. Sekretarja zj. Lin Biti lexon Betimin "Betohem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të këshillit bashkiak dhe do ti bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të Bashkisë Divjakë dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre." Ngrihet këshilltarja zj. Drita Metani dhe thotë "Betohem". Pas betimit të këshilltares, Sekretarja znj. Lin Biti ia jep fjalën për relatim, Sekretares së Komisionit të Ekonomisë dhe financave zj. Fotjona Budani, ku lexon Raportin e Komisionit Mbi shqyrtimin e Projektvendimeve për mbledhjen e muajit Dhjetor 2026.

5. Pika e pestë e Rendit të ditës.
- Për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar - 6%, për muajin Maj 2026.
Relatori z. Ledio Muço, Përgjegjës i Sektorit të mirëqenies sociale dhe Përkujdesit Shoqëror, ku i propozon këshilltarëve të miratojnë familjet në nevojë, dalë nga sistemi i pikëzimit me pikët e mjaftueshme, dhe që kanë aplikuar, pasi u është bërë dhe verifikimi në familje, të trajtohen me ndihmë ek. me fond deri 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Maj janë 14 familje me një fond prej 65203 lekë. Elizabeta Zeri 10682 lekë Afërdita Lupi 5940 lekë, Esmeralda Gjoka 7920 lekë, Vitrina Sula

5940 lekë, Jonca Albajrami 1525 lekë, Alketa Meta 5227 lekë,
Mimoza Krasniqi 2178 lekë, Bashkime Gjini 1525 lekë, Zegir Zegiri
3703 lekë, Neim Dore 5227 lekë, Suzana Muça 5940 lekë,
Bardhul Torko 3703 lekë, Klodiana Ndoni 3703 lekë,
Ejona Toska 1980 lekë. Pyetje s'ka, Diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e pestë e rendit të ditës dhe votohet
me 19 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

6. Pika e gjashtë e rendit të ditës.
- Për miratimin e PBA të Bashkisë Divjakë për vitet
2027-2029, Faza e parë.
Kryetarja znj. Lin Bita, ia jep fjalën për relatim Përgjegjëses
së Sektorit të buxhetit dhe financës znj. Gerina Drifti, ku i
propozon këshilltarëve të miratojnë PBA për vitet 2027-2029
fazën e parë me këto shifra:

| Nr. Burimet buxhetore: | Parashikimi në lekë v.2027 | v.2028 | v.2029. |
|---|---|---|---|
| 1. Trashëgimi nga v. kaluar. | 73.677.739 | 65123.162. | 50.000.000. |
| 2. Të ardh. nga bur. veta. | 230.468.000. | 230.979.000. | 231.681.000. |
| 3. Transf. pakusht. përgj. | 323.368.000. | 337402.000. | 350.825.000. |
| 4. Niveli i rrit. pagës. T.P. | 57.741.000 | 57.741.000. | 57.741.000. |
| 5. Transf. pakusht. sektoriale | 193.005.644. | 193.005.644. | 194.935.699. |
| 6. Projekti Jainable fin. huaj. | 3.538.362 | 0 | 0. |
| Totali | 881.798.745. | 884.250.806. | 885.182.699. |
| 7. Transferta e kushtëzuar. | 288.600.000. | 288.600.000. | 288.600.000. |
| Totali i të Ardhurave. | 1.170.398.745. | 1.172.850.806. | 1.173.782.699. |

Shpenzimet e NJ.V.Q. sipas njësive shpenzuese është si vijon: në lekë.

| Njësia e Shpenzimit | Kodi | Plani v.2027 | v.2028 | v.2029. |
|---|---|---|---|---|
| - Bashkia Divjakë | 2147001 | 751.359.000 | 753.811.000 | 754.743.000 |
| - Agjencia e Shërb. Kom. | 2147003 | 130.440.000. | 130.440.000 | 130.440.000 |
| Totali | | 881.799.000 | 884.251.000 | 885.183.000. |

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik ne pjesën parashikuar për
transfertat e kushtëzuara. Plani në 000. lekë.

| | 2027 | 2028 | 2029 |
|---|---|---|---|
| - Shpenzime personeli (600-601) | 469.908 | 468.277 | 468.277. |
| - Shpenzime korente + të tjera | 270.626 | 267.787 | 268.719 |
| - Shpenzime kapitale | 141.264 | 148.187 | 147.187 |

Pas relatimit të Përgjegjëses së Sektorit të financës dhe Buxhetit
Kryetarja znj. Lin Bita i drejtohet këshilltarëve: A keni pyetje

Project: Date ...... /...... / ...........

apo diskutime, për pikën e gjashtë të rendit të ditës? Tjetër
s'ka, diskutoi z. S. Ibrahimaj duke u shprehur se E kam
dhënë mendimin tim në mbledhjen e komisionit, për
arsye të mungesës së projekteve të investimeve. Diskutime
të tjera s'ka. Hidhet në votim pika e gjashtë e rendit të
ditës dhe votohet me 18 vota pro, asnjë kundër dhe
asnjë abstenim. Një këshilltor nuk votoi.

7. Pika e shtatë e rendit të ditës.

- Për një ndryshim në VKB Nr. 19 dt. 27.2.2026 "Për transferimin e fondeve nga Buxheti i Bashkisë Dibër në shoqërinë "Rjela shpk. Sekretarja znj. Din Bili ia jep fjalën për relatim znj. G. Pinfa, e cila i propozon këshilltorëve, ndryshimin e VKB nr 19 dt. 27.2.2026 "Për transferimin e fondeve nga buxheti i Bashkisë në shoq. Rjela shpk. si vijon: Transferimi i fondeve nga Bashkia në favor të shoqërisë Rjela shpk të realizohet sipas funksioneve të transferuara. Fondet e transferuara sipas VKB nr 19 dt. 27.2.2026 me nr. U. shp. 355 dt. 18.5.2026 në vlerën 6.437,238, të zbriten nga vlera e buxh. të rish. për transferim. Fondet e parashikuara në VKB nr 19 dt. 27.2.2026, të rishikohen sipas nevojave aktuale dhe ecurisë së realizimit të funksioneve të shoq. në uljen e fondit të krahasuar me VKB nr 19 dt. 27.2.2026. Dosja për i keni bashkëngjitur me projekt vendimin. Sekretarja znj. Din Bili: A keni pyetje apo diskutime për pikën e shtatë të rendit të ditës? Tjetër s'ka, diskutime s'ka.

Hidhet në votim pika e shtatë e rendit të ditës dhe votohet me 19 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

8. Pika e tetë e rendit të ditës.

- Për një ndryshim në VKB Nr 90 dt. 29.12.2025, për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë, institucioneve në varësi dhe të Njësive Administrative për v. 2026.

Për këtë pikë relatoi specialistja e pagave në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit znj. Amarilda Sina, ku i propozoi këshilltorëve të miratojnë ndryshimin në VKB nr 90 dt 29.12.2025 "Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë, institucioneve në varësi dhe Nj. Adm. për v. 2026. Ky propozim vjen si rezultat i vlerësimit të kontributit të tyre të vazhdueshëm, në përmbushjen e detyrave funksionale nivelit të lartë të performancës dhe rritjes së ngarkesës së punës. Efektet financiare të këtij propozimi të fillojnë me 1.7.2026. Tjetër s'ka, diskutime s'ka.

Hidhet në votim pika e tetë e rendit të ditës dhe votohet me 19 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

9. Pika e nëntë e rendit të ditës.
- Për një miratim të dhënies së ndihmës financiare për shtetasin Renato Arixhiu për banesën e dëmtuar nga zjarri.
Kryetarja znj. Lin Bili ia jep fjalën për relatim z. Ferit Dosja, specialist agronom për emergjencat civile pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Mjedisit dhe Pyjeve.
z. F. Dosja i propozon Këshilltarëve, të miratojnë dhënien e ndihmës financiare për shtetasin z. Renato Arixhiu, banesa e të cilit është djegur plotësisht nga zjarri i rënë më datë 13.05.2026, dhe kjo ndihmë shkon në vlerën 503.900 lekë. Kjo vlerë do të përballohet nga fondi i kushtëzuar për v. 2026, nga programi "Emergjencat civile". Pyetje: z. S. Ibrahimaj: A do të përballohet nga emergjencat civile? Po. përgjigjet z. F. Dosja. Pyetje të tjera s'ka, diskutime s'ka. Hidhet në votim pika e nëntë e rendit të ditës dhe votohet me 19 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

10. Pika e dhjetë e rendit të ditës.
- Mbi akordimin e ndihmës financiare për subjektin "Agrigose"
Relaton përsëri z. F. Dosja për këtë pikë, ku i propozon këshilltarëve, të miratojnë akordimin e ndihmës financiare për subjektin "Agrigose" me Administrator z. Edmond Zhuri në vlerën 100.000 (njëqindmijë) lekë. Burimi i financimit për këtë ndihmë do të jetë nga buxheti i v. 2026, grupi 00, programi 01110, llogaria 602, zëri "Të tjera"
Pyetje s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e dhjetë e rendit të ditës dhe votohet me 19 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

11. Pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës.
- Mbi akordimin e ndihmës financiare për familjet e dëmtuara nga zjarri.
Kryetarja znj. Lin Bili ia jep fjalën për relatim z. F. Dosja ku ky i fundit i propozon këshilltarëve të pranishëm, të miratojnë akordimin e ndihmës financiare për familjet:
1 - Familja e z. Asqeri Kajmak Ismaili në vlerën 100.000 lekë
2 - Familja e z. Renaldo Spiro Ndoni në vlerën 100.000 lekë.

Project: Date ...... /...... / ..........

Burimi i financimit për këto familje do të jetë Buxheti i v. 2026, grupi 00, programi 01110, llog. 602, zëri "të tjera".

Kryetarja znj. Dina Biti: A keni pyetje apo diskutime për pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës?

Pyetje z. S. Ibrahimaj: A mund ti ndani në 2 pr. vendime të veçanta këto familje?

Përgjigjet z. F. Dosja: Meqenëse kanë të njëjtën fatkeqësi, i përfshimë në të njëjtin pr. vendim.

Pyetje të tjera s'ka, diskutime s'ka.

Hidhet në votim pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës dhe votohet me 19 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

12. Pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës, shtesë në r. ditës.

- Mbi miratimin për familjet në nevojë për dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme.

Relatoi përgjegjësi i sektorit të Mirëqenies sociale dhe përkujdesit shoqëror z. A. Muco, kei i propozon këshilltarëve: Të miratojnë një ndihmë të menjëhershme në masën 30.000 lekë për znj. Enkelejda Coska e cila ndodhet në kushte të vështira sociale dhe ekonomike.

- Të miratojnë një ndihmë të menjëhershme në masën 20.000 lekë për zj. Vangjelina Stambolliu, për kushte të vështira ekonomike e sociale. Propozoj që ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2026 në zërin "të tjera"

Kryetarja znj. D. Biti: A keni pyetje apo diskutime?

z. Sahit Ibrahimaj: Unë nuk e votova këtë projektvendim edhe në mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe financave, sepse ky propozim nuk është në kompetencën e këshillit Bashkiak për ndihma të menjëhershme, por miraton vetëm kriteret. Kjo ndihmë është në kompetencën e Kryetarit të Bashkisë dhe e jep me Urdhër të veçantë.

Pyetje dhe diskutime të tjera s'ka.

Hidhet në votim pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës dhe votohet me 18 vota pro, asnjë votë kundër, asnjë votë abstenim dhe një këshilltar nuk mori pjesë në votim.

13. Pika shtesë e trembëdhjetë e rendit të ditës
- "Për anullim të VKB nr 45 dt. 25.05.2026" "Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare nga fondi i kushtëzuar shtetasve të cilëve u janë dëmtuar banesat nga fatkeqësi të ndryshme.

Relator z. Feit Dosja specialist i emergjencave civile dhe i propozon këshilltorëve të miratojnë anullimin e vend. të KB nr 45 datë 25.5.2026, duke iu referuar edhe konfirmimit ligjor të Prefekturës të këtij vendimi ku theksohet - Sjellim në vëmendjen tuaj se efektet financiare të ligjit nr 45/2019 "Për mbrojtjen civile" shtrihen nga data 01.07.2020, kur në këtë vendim ishte përfshirë një familje me ndodhin e fatkeqësis para vitit 2020, në vitin 2010. Njeri s'ka, diskutime s'ka.

Hidhet në votim pika e trembëdhjetë shtesë në rendin e ditës dhe votohet me 19 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

14. Pika e katërmbëdhjetë shtesë në rendin e ditës.
- Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare nga fondi i kushtëzuar shtetasve të cilëve u janë dëmtuar banesat nga fatkeqësi të ndryshme.

Kryetarja znj. Liri Bita ia jep fjalën për relatim z. Feit Dosja, spec. i emerg. civile, i cili i propozon këshilltorëve të miratojnë: dhënien e ndihmës financiare z. Erjon Shehu në vlerën 852,714 lekë, z. Ernest Dosja në vlerën 286,451 lekë, z. Fatmir Kocabumi në vlerën 1,330,950 lekë, z. Bajor Manaj në vlerën 1,028,425 lekë.

Burimi i financimit është nga fondi i kushtëzuar për vitin 2026, transferuar nga Ministria e Mbrojtjes, programi "Emergjencat Civile" artikulli 604, kodi i produktit 91707AB, shtesat për të ndihmuar familjet banesat e të cilave janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme.

Kryetarja znj. Liri Bita i drejtohet këshilltorëve: A kemi pyetje apo diskutime për pikën shtesë të rendit të ditës, pikën e katërmbëdhjetë? Njeri s'ka, diskutime s'ka.

Hidhet në votim pika e katërmbëdhjetë shtesë e rendit të ditës dhe votohet me 19 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

Project: Date ...... /...... / ...........

15. Pika e pesëmbëdhjetë e rendit të ditës.
- Relacion mbi monitorimin e zbatimit të buxhetit për periudhën Janar-Prill 2026.
Relatoi zj. Gerina Dojli(?), Përgjegjëse pranë Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, ku theksoi para këshilltarëve realizimin e të ardhurave për periudhën Janar-Prill 2026, vuri në dijeni këshilltarët nëpërmjet këtij Relacioni edhe realizimin e shpenzimeve për periudhën Janar-Prill 2026.
I përmend si të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara për këtë periudhë në 000/lekë dhe në % të realizuar.
Në këtë Relacion përmend gjithashtu dhe karakteristikat kryesore të performancës së shpenzimeve Janar-Prill 2026.
Pyetje dhe diskutime nga këshilltarët për Relacionin nuk ka.

16. Pika e gjashtëmbëdhjetë shtesë në rendin e ditës.
- Informacion për kërkesën e këshilltarit z. S. Ibrahimaj.
Lexohet Informacioni z. A. Dosja(?). Pas leximit të informacionit merr fjalën këshilltari z. S. Ibrahimaj.
z. S. Ibrahimaj: Në Drejtorinë e Bujqësisë Lushnje(?) a keni dëgjuar shkresë për dëmtimet e karkalecit në kulturat bujqësore? A jeni takuar me fermerët për këtë problematikë, a i keni konstatuar sasinë(?) e dëmtuara, a keni bërë operacione trajtimi dhe a i keni publikuar njoftimet për fermerët për masat që duhet të marrin për dezinfektim, para shfaqjes së brezave të dëmtuesit?
Ne si specialistë të bujqësisë pranë Drejtorisë së Bujqësisë në Bashki, duhet të jemi pranë çdo fermeri dhe të konstatojmë problematikat e çdo fermeri për dëmtuesit dhe sëmundjet e kulturave bujqësore.
Drejtoria e Bujqësisë bëri Njoftime, shpallje emergjente nëpërmjet Administratorëve të Nj. Adm., Kryetarëve të fshatrave dhe ka për detyrë të kryejë asistencë teknike tek çdo fermerë. Bëhet fjalë për në vazhdi-men, por tani karkaleci ka dëmtuar kaun(?) kulture.
Ti si specialist, agronom, nuk e ke vënë në dijeni fermerin për të marrë masa ndaj karkalecit, dhe dëm-tuesve të tjerë, sepse ju e dinit kur shfaqen breznitë.
Krahas kësaj po parashtroj dhe një problematik tjetër: Është koha e zjarreve. duhen bërë Njoftime

në çdo. Nj. Adm. për këtë situat emergjente nga temp e lartë.
Pra kemi punë vetëm me 5 Adm. e nj. Administrative.
Kryetarja zj. Din Biti: Kolegjne në zërin të tjera.
Këshilltorja zj. A. Gjini. A ka Bashkia fond për rikonstruksionin e shkollave. Po ju ve në dijeni se shkolla "Koli Sako" është shumë e dëmtuar, me lagështi dhe myk dhe po ndikon në shëndetin e nxënësve dhe të mësuesve.
Këshilltorja zj. E. Sinani: A keni planifikuar fonde për të gjitha shkollat?
Kësh. z. Sahit Ibrahimaj: Do lyerja e shkollave do të bëhet sivjet? Kësh. D. Stoja: Shkolla Remas do të fillojë të funksionojë? Kësh. G. Agolli: A keni planifikuar fonde për shkollën gradjan?
Për të gjitha pyetjet e këshilltoreve përgjigjet Kryetari i Bashkisë z. [illegible] Gorrea.
Këshilltari z. B. [illegible]: Nga problematikat e largimit të mbetjeve nga koshat në fshatin Goricaj, nëse është mundësia të shpeshtohet marrja e tyre çdo 2 ditë dhe jo 1 ditë në javë.
z. Sahit Ibrahimaj: Shikoj se makina teknol. merr vetëm mbetjet brenda koshave, dhe jo ato jashtë, të cilat dekompozohen nga temp. e lartë dhe ndotin ambientin. Dhe pastrimi duhet të dezinfektoni me klor dhe me gëlqere. Përgjigjet Kryetari i Bashkisë.
Pyetje z. G. Agolli: Kjo firma që merr e larte, porozhdon për vendosjen e kapakëve? zj. A. Canaku: Janë mbushur pusetat me mbetje. Përgj. Kryetari i Bashkisë: Duhen ndërgjegjësuar njerëzit.
z. S. Ibrahimaj: Kryetare e propozoj tani sipas rreg. shtesën në r. e ditës për P. vendimin e tregut të peshkut. Përgjigjet Kryetarja zj. D. Biti: Në bazë të nenit 62 të rregullores së KB Kërkesa për të futur një çështje në rendin e ditës së Mbledhjes së KB duhet të bëhet me shkrim të paktën 5 ditë përpara datës së vendosur për mbajtjen e mbledhjes.
Ky projektvendimi Nr. 69 datë 26.6.2026 më ka ardhur sot dhe asnjë këshilltor nuk është njohur me materialet e këtij projektvendimi.
Do të zbatojmë rregulloren. Nëse është emergjente të bëhet kërkesa për mbledhje jashtë radhe.
z. S. Ibrahimaj: Kryetare hidhe në votim propozimin.
Kryetarja zj. Din Biti e deklaron Mbledhjen e KB të mbyllur.

Project: Date ...... /...... / ...........

VO: Kryetarja nuk pranoj të Hedhe në votim Propozimin e Keshilltarit.

Sahit Ibrahimi

Sekretari i KB
Mimoza Gliomaj

Elmerina Gina

Mikel Vefalla

Kryetari i KB
Lorin Bitte

Marjanda Xharo

Melda Simoni

Adelajda Çeku

Adelajda Suli

Antuela Gjeni

Ajete Mezelli

Dita Metani

Blerim Dardha

Donika Stasa

Roza Troshku

Indrit Zgjana

Fatjona Dodani